



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3860/prot.
10

Pogradec, më 23, 10, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për: **"PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR, PËR NDËRTIMIN PARKU ELOIK NË BASHKINË E POGRADECIT NGA SHOQËRIA "REXN ALBANIA" shpk"**.

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 23(Njezet e tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, 2025

PROJEKT- VENDIM

NR. _____, DATË _____, 2025

PËR

**MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR, SIPERFAQJA 45000 M2 PËR QËLLIME
NDËRTIMIN E PARKUT ELOIK NË BASHKINË E POGRADECIT
SUBJEKTIT "REXN ALBANIA" shpk .**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit Nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", pikën 4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjitikës", Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/ bashkive", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Në referim të bazës ligjore të sipercituar, ky proces të kryhet sipas percaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të percaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtaritë ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", si dhe bazuar në shkresë Nr. 7754 Prot, datë 28/10/2021, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me lëndë "Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës", si dhe shkresë Nr.2882/2 prot datë, 22.10.2025 drejtuar Bashkisë Pogradec nga shoqëria Renx Albania shpk me lëndë "Kërkesë për dhënie në leje për instalimin e shtyllës matëse për identifikimin e intesitetit të erës në territorin në administrim të Bashkisë Pogradec, me synimin e ndërtimit të parqeve eolike", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:



1. Të miratojë, dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, në të cilat do të ngrihet parku eolik, për prodhim energjie nga era:

<i>Nr</i>	<i>X</i>	<i>Y</i>	<i>Bashkia</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Nr. Pas</i>	<i>Ngastrat Pyjore /Kullosore</i>	<i>Përdorimi</i>
Q_08	466034.94	4540304.40	Pogradec	3188	350	5c	Pyll cungishte
Q_09	465779.32	4538905.06	Pogradec	3665	10	12K	Kullotë
Q_10	465408.83	4537888.91	Pogradec	3665	486	12K	Kullotë
Q_13	465896.63	4535563.75	Pogradec	1959	456	11K	Kullotë
Q_14	466387.59	4534947.66	Pogradec	1959	822	10a	Pyll cungishte
Q_15	466638.23	4534387.33	Pogradec	1393	10/1	10a	Pyll cungishte

Gjithsej 6 Turbina nga 7500 m2 sejcila siperfaqja totale 45000 m2 ose 4.5 Ha.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor /kullosor publik", subjekti "Renx Albania" shpk duhet të paraqesë dokumentacionin teknik-ligjor të kërkuar pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, e cila ka të drejtën për hartimin e studimit teknik-ekonomik të sipërfaqes objekt përdorimi.

3. Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "8", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

4. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje.

5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë, pasi të jetë hartuar raporti tekniko –ekonomik.

6. Ngarkohet Agjensia e Mbrojtjes Teritorit,Sektori i Sherbimi Pyjor, Sektori i Verifikimit titujve pronesise për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

8. U shpall sot më datë __. __.2025.

KRYETARE E KESHILLIT
Manjola KAMOLLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, 2025

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN ME OBJEKT

**“PËR
MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR, PËR NDËRTIMIN PARKU ELOIK NË BASHKINË
E POGRADECIT NGA SHOQËRIA “RENX ALBANIA” shpk .**

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Nga ballafaqimi i kryer ne fletorja zyrtare Nr. 159, konstatojme se është botuar Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr.584, datë 8.10.2021 *"Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", me anë të së cilit është bërë shpallja e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.*

Për sa më sipër, Qeveria Shqiptare me Kryeminister Edi Rama, vlereson se ndertimi dhe instalimi i paneleve elektrike dhe/ose parqeve te eres Eolike (shfrytezimi i burimeve te rinovueshme te eres dhe diellit) , cshte nje rendesie tejet te larte, ne menyre qe te plotesohet nevojat e brendshme me energji elektrike dhe te krijohet 'pavaresia" nga importi i energjise nga jashte.

Aplikimi, ndertimi dhe zhvillimi i nje teknologjie te tille, është me rendesi jetike jo vetem për Bashkine Pogradec por per te gjithë Republiken e Shqiperise.

Të njëjtin qendrim ka mbajtur edhe znj. Belinda Balluku, Ministre e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, e cila me shkresen Nr. 7754 Prot, datë 28/10/2021, me lëndë *“Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës”,* i ka kerkuar bashkepunimin e te gjitha Bashkive te Republikes se Shqiperise, qe ne rast te nje kerkese nga ofertuesit potenciale, te lehtesohet procesi dhe te mbesheten, ne lidhje me lejet, autorizmet ose te drejtat mbi token me qellim zhvillimin e fushates se matjes se eres.

Per sa me siper, Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë (MIE) e Republikës së Shqipërisë, ne muajin Qershor 2021, ka hapur një proces konkurrues për impiantet për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia e erës (eolike) me kapacitet të lartë dhe me vendndodhje në tokë.

MIE fton Ofertuesit Potencialë të identifikojnë dhe të propozojnë vendndodhje të përshtatshme për projektimin, financimin, ndërtimin dhe operimin e një impianti eolik të ri në tokë.



Për të ndihmuar Ofertuesit Potencialë, MIE ka porositur një analizë të përgjithshme të erës të territorit shqiptar për të treguar zonat potencialisht të përshtatshme për zhvillimin e projekteve të reja eolike si dhe zonat e papërshtatshme/të papranueshme për zhvillimin e projekteve të energjisë së erës të përcaktuara si "të kufizuara" ose "zona të ndaluara".

Pjesëmarrja në këtë proces konkurrues lejohet vetëm për projekte me një kapacitet minimal prej 10 MW dhe kapacitet maksimal prej 75 MW. Nëpërmjet këtij procesi konkurrues MIE do të përzgjedhë Projekte me një kapacitet të përgjithshëm prej 100 MW të cilët do të përfitojnë masat mbështetëse që përshkruhen më poshtë. Autoriteti Kontraktues, më vonë mund të vendosë që të rrisë kapacitetin total të tenderuar deri në 150 MW.

Procesi Konkurrues do të kryhet në dy faza:

I. Kërkesa për Kualifikim (KPK) synon para-kualifikimin e Ofertuesve Potencialë që gëzojnë eksperiencën e duhur teknike, burimet financiare dhe pozitën ligjore për të përfunduar një Projekt.

II. Kërkesa për Propozim (KPP) gjatë së cilës secili nga Ofertuesit e Para-Kualifikuar duhet të provojë realizueshmërinë e projektit në vendndodhjen e propozuar dhe të dorëzojë një Ofertë Financiare

Per sa me siper, MIE me ane te shkreses se sipercituar ka sqaruar se, cdo Ofertues Potencial do te filloje aktivitetin per te provuar prodhimin e raportit te prodhimit te energjise, bazuar ne matjet e cres ne vendndodhje per te pakten 1 vit, sic kerkohet nga praktika me e mire e industrise.

Dhe cka eshte me e rendesishmja, para instalimit te shtyllave matese ose pajisjeve te tjera te nevojshme per fushaten e Matjes se Eres, secili Ofertues Potencial duhet te marre pelqimin e pronarit te tokes ku do te ngrihen shtyllat matese ose pajisjet e tjera.

Sipas shkrases Nr.2882/2 prot datë, 22.10.2025, drejtuar Bashkisë Pogradec, shoqëria "Renx Albania" shpk, me lëndë "Kërkesë për vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontrates , me synimin e ndërtimit të parqeve eolike", duke marre ne konsiderate kontraten se lidhur me pare me Bashkiane Pogradec nr prot 3468 date 19.07.2022, ka perfunduar procedurat e matjes se Eres dhe kane rezultuar me rezultate pozitive dhe mbas kesaj shoqeria eshte paisur edhe me autorizimin perkates nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise Miratim Paraprak nr 4462/3 date 21.05.2024, dhe rezulton se keto turbina do te ngrihen ne siperfaqe qe jane ne fond pyjor/kullosor.

Theksojme se konsultimi publik eshte realizuar ne date 07.11.2024, me prezencen e perfaqesuesve te Bashkise te firmes dhe pjesetare te komunitetit. Siperfaqja e kerkuar eshte percaktuar ne projektvendim dhe eshte 7500 m2 per turbine dhe te barabarte 4.5 Ha.

Referuar, shkronjës "j" të pikës 22 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik", bëjnë përjashtim nga konkurrimi publik dhënia e sipërfaqeve në përdorim rastet kur persona fizikë/juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me:

- *procedurat në zbatim të ligjit për ndërtim të kullave për parqet eolike dhe infrastrukturën ndihmëse.*

Pas marrjes se pelqimit nga Keshilli i Bashkise Pogradec, per dhenien ne perdorim te siperfaqeve ku do te ngrihen turbinat per prodhimin e energjise , subjekti i interesuar duhet te paraqesë dokumentacionin teknik-ligjor të kërkuar pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, e cila ka të drejtën për hartimin e studimit teknik-ekonomik të sipërfaqes objekt përdorimi.

Pas hartimit te raportit tekniko – ekonomik do te nenshkruset kontrata nga Kryetari i Bashkise Pogradec.

Per sa me siper, në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, kerkojme nga Keshilli i Bashkise Pogradec, qe ne cilesine e pronarit te miratoje projekt vendimin me objekt "Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, për qëllim ndërtimin parkut eolik Nga Shoqeria "Renx Albania" shpk në Bashkinë e Pogradecit".

Ju faleminderit!

Konceptoi: Nexhmi TORRA



Miratoi: Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



POGR' DEC
288/2 PROT
22-10-2024
om: Renx Albania Shpk <renxalbania@protonmail.com>
Sent: Wednesday, October 22, 2025 12:05:12 PM
To: Dritan Babasuli <Dritan.Babasuli@bashkiapogradec.gov.al>
Subject: Miratimi Paraprak nga MIE



You don't often get email from
renxalbania@protonmail.com. [Learn](#)
[why this is important](#)

KUJDES: Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Përshëndetje Dritan,

Në vijim të komunikimit tonë me email, bashkëngjitur këtij emaili po ju dërgoj Miratimin Paraprak që kemi marrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me datë 21.05.2024, për projektin e parashikuar të ndërtohet në zonën e Bashkisë Pogradec.

Për më tepër, nëpërmjet këtij emaili dëshirojmë të konfirmojmë vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontratës së qirasë me Bashkinë Pogradec, për sipërfaqet ku do të shtrihet projekti i parashikuar dhe i miratuar paraprakisht nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithë të mirat,
Jurgeni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 43 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, i jepet:

SHOQËRISË "RENX ALBANIA" SH.P.K. MIRATIM PARAPRAK

(PËR VAZHDIM PROCEDURE)

Nr. 4462/3, datë 21.05.2024

"Për ndërtimin e implantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 120 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në zonën e Bashkisë Pogradec, Qarku Korçë"

Afati i vlefshmërisë: 6 muaj

ZËVENDËSMIRISTRI
ENKELEJDA MUÇAJ

Shoqëria "RENX ALBANIA" sh.p.k.

Adresa: Rruga "Komuna e Parisit", Kompleksi "Kika", H. Nr. 1, Ap. Nr. 35, Tiranë.

Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT/NUIS: M12410031Q

Objekti: E drejta ekskluzive e Shoqërisë "RENX ALBANIA" sh.p.k për të bërë matje dhe studime të tjera të nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm sipas nenit 20 të V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*", e ndryshuar, për pajisjen me dokumentacionin përkatës për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 120 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonën e Bashkisë Pogradec, Qarku Korçë.

Shoqëria "RENX ALBANIA" sh.p.k, në zbatim të nenit 20 të V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*", e ndryshuar, për procedimin e mëtejshëm për pajisjen me autorizimet dhe lejet përkatëse, duhet që brenda 6 (gjashtë) muajve, të përfundojë dhe dorëzojë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentacionin si më poshtë vijon:

- a) Studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar, mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;
- b) Planin e biznesit të projektit;
- c) Grafikon e zbatimit të projektit;
- ç) Miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;
- d) Lejet, licencat dhe autorizimet mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
- e) Oponencën teknike për projektpropozimin nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

Ky miratim e humbet automatikisht vlefshmerinë në rast se Shoqëria "RENX ALBANIA" sh.p.k. nuk paraqet brenda afatit 6 muajor dokumentacionin e përcaktuar në këtë miratim.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2559 prot.

Pogradec, më 29.06.2023

VENDIM

Nr. 63, DATË 27/06/2023

PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PER QELIME
STUDIMI TE POTENCIALIT TE ERERAVE, DHE NDERTIMIN E
PARQEVE ELOIKE NE BASHKINE E POGRADECIT.

Ne mbështetje te; pikes 2 te nenit 8, pikes 1.2 genna "a" te nenit 9, te pikave S dhe 6 te nenit 27 dhe shkronjes "e" te nenit 54 te Ligjit Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen Vendore", I ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike" Ligjit Nr.7/2017 "Per nxitjen e perdorimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme", piken 4 te nenit 12 te Ligjit Nr. 57/2020, "Per pyjet", Kreun VT te Ligjit Nr.7850, date 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", I ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Per sektorin e energjitikes", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 433, date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listes se inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit dhe ish-komunave/ bashkive", i ndryshuar, Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 822, date 7.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe nuk jane objekt koncesioni", neni 20 dhe neni 23 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.391, date 21.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar, shkronjes "j" te pikes 22 te Udhhezimit te Ministrit te Mjedisit Nr. 1, date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kerkeseve per dhënien në përdorim te fondit pyjor/kullor publik", si dhe bazuar në shkresën Nr. 775-1 Prot, date 28/10/2021, e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, me lëndë: "Kërkesë për bashkepunim mbi ankandin per energjinë e erës" dhe shkresën me nr. 2431 datë 13/06/2023 drejtuar Bashkise Pogradec nga shoqeria Renx Albania me lëndë "Kerkese per marrje me qera afatgjate te siperfaqes prej 2.26 Ha", në vijim të VKB-së Pogradec me nr. 114, datë 16/12/2021, me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli I Bashkise,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, me qëllim studimi te potencialit te ererave, me synim ndertimin e parqeve eloike, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr	Vëndodhja	Siperf në	Objekti kerkeses
----	-----	----	-----------	-----------	------------------

		Pasur		m2	
1	1832	460	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
2	2420	433	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
3			Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
4	2420	436	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
5	2420	435	Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
6	1442		Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
7			Dardhas - Pretushe	400	Marrje perdorim Pasurie
8	1214	845	Alarup	400	Marrje perdorim Pasurie
9	1208	433	Petrushë - Lin	400	Marrje perdorim Pasurie
10	1387	461	Alarup	400	Marrje perdorim Pasurie
11	3047	406	Dardhas - Petrushe	400	Marrje perdorim Pasurie
			Total	4.400	

- Administrata e Bashkisë do të kryejë verifikimin e statusit juridik dhe azhurnimin e pronave të mësipërme dhe të zbatojë legjislacionin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme juridike.
- Këshilli i Bashkisë për sipërfaqet e tjera të kërkuara nga subjekti sipas listës dhe hartës bashkëngjitur këtij vendimi, shpreh dakortësinë për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar gjithnjë duke plotësuar procedurat ligjore për pronësinë dhe ushtrimin e aktivitetit në zona të mbrojtura.
- Afati i dhënies me qera të jetë 9 vite, me të drejtë ripertëritje, sipas periudhes të përcaktuar në projekt, dhe studimin e fizibilitetit të dorëzuar nga kërkuesit në konkurim.
- Ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
- Tarifat për dhënie në përdorim/qera të këtyre pasurive, të aplikohen sipas shkronjës "c", pika 1 Kreu III të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
- Shoqëria kërkuese të përdorë pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objektit të parashikuar në kërkesën e saj dhe studimin e fizibilitetit të paraqitur për marrjen në përdorim të pasurive.
- Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij projektvendimi mbas përfundimit të procedurave konkurruese.
- Vendimi fillon ekzekutimin në momentin që do të do të vihen në dispozicion certifikatat e regjistrimit të pronësive në emër të Bashkisë Pogradec.
- Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
- Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI E KESHILLIT

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 3468 prot.

Pogradec, më 19.07.2022

KONTRATË QIRAJE
PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR

Ne zbatim të ligjit Nr. 139/ 2015, "Per vetqeverisjen vendore, të ligjit Nr. 57/ 2020, date 30.04.2020 "Per pyjet, të ligjit Nr 9693, datë 19/03/2007, "Per fondin kulllosor", të ndryshuar, si dhe të nenit 801 e në vijim të ligjit Nr.7850, date 29.07.1944, "Per kodin civil të Republikës së Shqipërisë" në VKM nr 433 date 08.06.2016 " Per transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/ Bashkive, të ndryshuar të VKM Nr. 1064 date 22.12.2010 për disa ndryshime në VKM Nr. 391 date 21.06.2006, " Per caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, në vendimin e Keshillit të Bashkiak Pogradec Nr 141 date 16.12.2021 " Per miratimin e dhenies në përdorim të fondit pyjor/ kulllosor, për qëllime studimi të potencialit të erërave, me synim ndërtimin e parqeve eolike në Bashkinë e Pogradecit" dhe të udhëzimit të ministrit të mjedisit Nr 1, date 09.06.2016, "Per rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit, e miratimit të kërkesave për dhenien në përdorim të fondit pyjor dhe kulllosor public."

Lidhet kjo kontratë qiraje nëpërmjet paleve

PALET

- A. **Bashkia Pogradec**, e përfaqësuar nga Kryetari **Z. Ilir XHAKOLLI** që këtu e me poshtë do të quhet "Qiradhenesi" dhe kështu do të thirret me poshtë.
- B. Shoqëria **RENX Albania sh.p.k** regjistruar si person juridik në qendrën kombëtare të regjistrimit me NUIS: **M12410031Q**, me seli në Tiranë rruga Komuna e Parisit, kompleksi Kika, shkalla 1, Ap 35 përfaqësuar nga Administratori, **Z. Afrim Vigani** i cili në këtë kontratë do të quhet "Qiramarrësi" dhe kështu do të thirret me poshtë.

Sa me sipër palet bien dakord si me poshtë:





DIZPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qene se ekzistojne kushtet paraprake te cilat perbejne pjese integrale te kesaj kontrate, palet bien dakord si vijon:

Kushtet paraprake dhe shtojcat.

Kushtet paraprake ashtu si dhe Shtojcat perbejne pjese integrale te saj.

Percaktime.

Siperfaqe perdorimi: Vendi ne te cilin do te ushtrohet veprimtaria per qellimin e ushtrimit te aktivitetit te saj, te miratuar.

Rruge kalimi/ E drejta e kalimit: Rruga nga rruga kryesore per te hyre ne siperfaqe e marre ne perdorim aktualisht eshte pjese e fondit pyjore/kullosor public, e administruar nga qiradhenesi, dhe do ti sherbeje subjektit.

Qiradhenesi: Autoriteti shteteror Bashkia Pogradec qe zoteron te drejten e perdorimit e pergjigjet per menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullosor.

Qiramarrës: Shoqeria RENX Albania sh.p.k perfaqesuar nga administratori Z AAfrim Vigani.

Neni 1

Objekti i kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte, dhenia me qera e dy siperfaqe te ndodhura ne ekonomine pyjore/kullosore, ne pronesi te Bashkise Pogradec, shoqerise "RENX Albania" sh.p.k, per vendosjen e anemometrave, per qellime studimi, per matjen e shpejtesise se eres, ne perputhje me vendimin Nr. 114, Date 16.12.2021, te Keshillit Bashkiak Pogradec "" Per miratimin e dhenies ne perdorim te fondit pyjore/ kullosore, per qellime studimi te potencialit te ererave, me synim ndertimin e parqeve eolike ne Bashkine e Pogradecit" te dy siperfaqieve prej 0.2 ha, sejcila, per vendosjen e anemometrave, ne teritorin e Bashkise Pogradec, me kufizime dhe koordinatat e poligonit te siperfaqes me qender koordinatat:

Sip 1: 40°53'37.584" N; 20°48'22.383" E

Sip 2: 40°51'43.563" N 20°43'12.199" E

sipas hartes pyjore kullosore ku jane pasqyruar te dhena te treguesve kadastral etj.

Neni 2

Qellimi

Kjo kontrate ka per qellim dhenien ne perdorim/qira te siperfaqes pyjore/kullosore te percaktuar ne Nenin 1 te kesaj kontrate per ushtrimin e veprimtarise per vendosjen e nje Anemometri, per qellime studimi per matjen e shpejtesise se eres.

Neni 3

Afati i kontrates

Afati i dhenies ne perdorim eshte per periudhen deri ne 1 (nje) vit duke filluar nga data 19.07.2022 deri ne date 18.07.2023.

Nje (1) muaj perpara perfundimit te afatit te mesiperm, secila Pale duhet te njoftoje Palen tjeter per te negociuar shtyrjen e afatit te kontrates.

Ne mungese te ketij njoftimi ose te nje komunikimi ndermjet paleve, kontrata do te konsiderohet e zgjidhur ne perfundim te afatit te percaktuar ne kete kontrate.



Neni 4



Vlera e kontrates

Vlera totale e qirase vjetore, e detajuar eshte:

Vlera e perdorimit per kryerjen e operacioneve te kerkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh te ndryshme ndihmese ne siperfaqe 96000 leke/vit.
Per kryerjen e operacioneve te kerkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh te ndryshme ndihmese ne siperfaqe eshte:

Kullote 0.2 ha x 96000 leke/ha/vit= 19 200 leke/ vit

Shuma: 19 200 (nentembedhjete mije e dyqind) leke/vit.

Vleren e kullotes, flores dhe faunes 200 Leke, e perbere nga:

Vlera e lendes se punimit 0 Leke

Vlera e druve te zjarrit 0 leke

Vlera e prodhimeve te dyta pyjore 0 leke

Kullotja 200 Leke

Vlera e faunes 0 leke

Shuma: 200 (Dyqind) Leke.

Pagesa per vitin e pare eshte: 19400 (Nentembedhjete mije e katerqind) Leke.

Neni 5

Pagesa dhe regjimi i saj

5.1 Pagesa e qirase do te behet sipas kushteve te kesaj kontrate

5.2 Pagesa do te behet brenda 4 (kater) diteve nga nenshkrimi i kesaj kontrate

5.3 Pagesa e qirase do te behet prane zyres se finances ne Bashkine Pogradec

5.4 Vlera e qirase eshte e pandryshueshme. Ajo do te ndryshoje vetem nese do te kete ndryshime te aktit nenligjor V.K.M. 1064 date 22.12.2010, per disa ndryshime ne Vendimin Nr. 391, date 21.06.20006 te keshillit te ministrave "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyejeve dhe kullotave.

5.5 Ne rast se Qiramarresi nuk do te kryeje pagesen sipas kushteve te vendosura sa me siper, Qiradhenesi perfiton nje kamate vonese prej 0.1% per cdo dite vonese, por jo me shume se 10% te vleres totale te vleres se pageses perkatese. Per efekt te llogaritjes se kamatvonesave do te konsiderohet data e percaktuar ne piken 5.2 te kesaj kontrate.

Neni 6

Te drejtat dhe detyrimet e qiradhenesit

6.1 Qiradhenesi merr persiper dhe i krijon qiramarresit mundesine qe te gezoje dhe ta perdure ate qetesisht ndaj pretendimeve te pabazuara ligjesisht te ngritura ng ate tretet.

6.2 Qiradhenesi nuk pergjigjet per pretendime te tjera qe nuk kane te bejne me siperfaqen e dhene ne perdorim me objektin dhe qellimin e kontrates.

6.3 Qiradhenesi ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e njeanshme te kontrates kur qiramarresi nuk ka shlyer vleren e qirase sipas percaktimeve te neneve 4 dhe 5 te kesaj kontrate, demton ose nuk miremban e permireson siperfaqen e marre ne perdorim, nuk permbush detyrimet qe rrjedhin nga kontrata apo te percaktuara ne planin e rehabilitimit dhe kushtet e lejes mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi qe rregullojne veprimtarine ne fushen e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

6.4 Qiradhenesi miraton planin e rehabilitimit te mjedisit pyjor object perdorimit, monitoron dhe merr ne dorezim siperfaqen pas rehabilitimit.

6.5 Monitoron ne vite detyrimet qe rrjedhin nga kontrate e oerdorimit dhe kryerjen e procedurave ne terren gjate fazes se ndertimit, perdorimit te siperfaqes pyjore dhe pyllhezimit, etj.





Neni 7

Te drejtat dhe detyrimet e qiramarresit

7.1 Me nenshkrimin e kesaj kontrate "Qiramarresi" ka te drejte qe per te punesuarin e tij, agjente, perfaqesuesit dhe cdo person tjetër qe Qiramarresi I konsideron te pershtatshem, te kete te drejten te hyje lirisht ne pronen object te kesaj kontrate, te kryeje cdo veprim te cilin mund ta konsideroje te nevojshem ose te dobishem gjate ushtrimit te aktivitetit te tij, te transportoje mallra paisje dhe materiale te tjera brenda siperfaqes se marre me qira, te beje ndertime te perkohshme ose te perhershme, si dhe punime te tjera ne perputhje me kerkesat e planit te rehabilitimit te siperfaqes object perdorimi dhe kushteve te Lejes Mjedisore per ushtrimin e aktivitetit te saj.

7.2 Qiramarresi nuk mund te transferoje te drejten e siguruar nga kjo kontrate per perdorimin e siperfaqes se marre ne perdorim, te treteve, pa marre me pare miratimin nga Qiradhenesi per ushtrimin e veprimtarise

7.3 Qiramarresi nuk ka te drejte te jape me qira dhe te lidhe nen kontrakte me subjekte te tjere apo t'ja kaloje kontratat e lidhur nje subjekti tjetër.

7.4 Qiramarresi do te kryeje me shpenzimet e veta cdo punim mirembajtje qe do ti konsideroje te nevojshme ne siperfaqen e marre ne perdorim dhe ne Rrugen e Kalimit.

7.5 Qiramarresi do te perdure siperfaqen e marre ne perdorim dhe Rrugen e Kalimit me qellim per te ushtruar aktivitetin qe percaktohet ne 7.6 Qiramarresi te mbroje dhe mire administroje siperfaqen pyjore/ kullosore ne perputhje me dispozitat e Ligjit 57/2020 date 30.04.2020 "Per Pyjet", dhe te Ligjit 9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullosor", te ndyshuar.

7.7 Qiramarresi te lejoje dhe te shoqeroje punonjesit e Ministrise se Mjedisit dhe te Bashkis te ushtrojne kontrole per zbatueshmerine e kerkesave te percaktuara ne kontrate per siperfaqen e fondit pyjor /kullosor te dhene ne perdorim.

7.8 Qiramarresi detyrohet te zbatoje cdo dispozite ligjore qe del e re ose ndryshim qe u behet atyre ekzistuese per pyjet, kullotat dhe gjuetine.

7.9 Per cdo shkelje te konstatuar ne zbatim te pikave te mesiperme te kontrates, zbatohen kerkesat e ligjit 57/2020 date 30.04.2020 "Per Pyjet"

7.10 Harton dhe miraton ne Bashkine Pogradec Planin e rehabilitimit dhe ndjek zbatimin e tij

7.11 Kryen pagesat e menjehershme, te fondit pyjor dhe kullosor public, per lenden drusore dhe pasurite e tjera pyjore qe hiqen gjate kryerjes se punimeve dhe per vleren e perdorimit te siperfaqes, per vitin ne vijim.

Neni 8

Detyrime te perbashketa te paleve

Ne fund te periudhes se kesaj kontrate ose ne perfundim te saj, "Qiramarresi" do te rehabilitoje siperfaqen, per cdo deptim qe mund te jete shkaktuar gjate veprimtarise, dhe do ta dorezoje siperfaqen e marre, sic ishte ne gjendjen fillestare, pervec konsumimit fizik normal.

Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve do te behen me shkrim ne adresat e meposhtme:

Per Qiradhenesin: Bashkia Pogradec, Adresa: Lagjia 12. Blv. "Shen Gjergji" nr 12

Per Qiramarresin: "Shoqeria RENX Albania sh.p.k rregjistruar si person juridik ne qendren kombetare te regjistrimit me NUIS: M12410031Q, me seli ne Tirane rruga Komuna e Parisit, kompleksi Kika, shkalla 1, Ap 35 perfaqesuar nga Administratori Z. Afrim Viganj

Neni 9

Forcat madhore





Ne rast se ndonje nga Palet e kesaj Kontrate pengohet te permbushe te gjitha ose nje pjese te detyrimeve te saj te parashikuara ne kete Kontrate si pasoje e Forces Madhore, kjo Pale muk do te jete pergjegjese per mospermbushjen e detyrimeve te saj gjate kohezgjatjes se Forces Madhoredhe per pasojat e shkaktuara dhe qe rrjedhin nga Forca Madhore. Pezullimi i ekzekutimit te kesaj Kontrate si pasoje e Forces Madhore do te kufizohet ne periudhen e kohes gjate se ciles do te vazhdojne efektet e Forces Madhore.

Neni 10

Zgjidhja e kontrates

10.1 Kjo kontrate perfundon ne momentin e perfundimit te afatit te saj te percaktuar ne nenin 3.

10.2 Kontrata zgjidhet perpara mbarimit te saj, vetem per shkak te ndryshimit dhe mosrespektimit te kushteve kontraktore, te moskryerjes se pageses se qirase ne afatin e caktuar, te kushteve te lejes mjedisore.

10.3 Njoftimi per zgjidhjen e e njeanshme te kontrates behet me shkrim 15 dite perpara zgjidhjes se saj.

10.4 Kontrata zgjidhet menjehere kur siperfaqja e dhene ne perdorim kerkohet per linteresa publike te miratuara nga A.K.P.T

Neni 11

Ndjekja e kontrates

Per ndjekjen dhe zbatimin e kontrates ngarkohet Sektori i Sherbimit Pyjor prane Bashkise Pogradec.

Neni 12

Dispozita te fundit

11.1 Per ceshtjet qe nuk trajtohen ne kontraten e mesiperme ne rast se do lindin mosmareveshje midis paleve, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil qe trajtojne kontraten e qirase.

11.2 Mosmareveshjet gjate zbatimit te kesaj kontrate, zgjidhen me mirekuptim te paleve ne te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmareveshjeve do te jete Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqesor Pogradec ose Gjykata e Rrethit Gjyqesor Pogradec.

11.3 Cdo korrigjim i kontrates para dhe pas nenshkrimit te saj , e ben te pavlefshme.

11.4 Kjo kontrate eshte e vlefshme vetem me harten bashkengjitur saj.

Kjo kontrate qiraje u formulua ne kater kopje origjinale, nje prej te cilave i jepet Qiramarrësit

PALET

QIRADHËNËSI
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETAR
Ilir XHAKOLLI



QIRAMARRËSI
SHOQËRIA "RENX Albania" sh.p.k
ADMINISTRATORI
Afrim VIGANI





SHTOJCA 3

RAPORTI I KONSULTIMIT FILLESTAR ME ZYRTARËT LOKALË TË NJESIVE ADMINISTRATIVE DHE ANËTARËT E KOMUNITETIT NGA FSHATRRAT PËRRETH.

Date 07/11/2024

Ora 10:00-11.15

MINUTAT E TAKIMIT

Në takimin e njoftuar me shkresë Bashkisë Pogradec morën pjesë:

BASHKIA POGRADEC

1. Z. Ilir Xhakolli - Kryetari i Bashkisë
2. Z. Nexhmi Tora - Sektori i Titujve të pronësive
3. Z. Kledi Lufo - Specialist i Pyjeve

NJAD UDENISHT ,Z. Klodian Selko

Kryeplaku i fshatit Cervenak -z. Sefedin Palla/ 0685594345

Kryeplaku i fshatit Udenisht -z. Adriatik Dokollari /0677401603

Ekspertet e Mjedisit (Environmental Management Consultants)

1. Znj.Elidiana Shehu -Eksperte Mjedisit-EmcStudio
2. Klodian Ali -Ekspert Mjedisit
1. Z. Astrit Pjetri-Kryetar i Fshatit Spac

Konsultimi për procesin e Vlerësimit të ndikimeve në Mjedis me Komunitetin e lajmëruar dhe e njoftuar për të zhvilluar në datën 07/11/2024, Ora 10:00, në Ambjentet e Hotel Lyhnidas Pogradec pranë Zonës së Projektit.

Konsultimi me palë interesi filloi në orën 10:05, me prezantimin e Projektit nga Ekspertet e Mjedisit Znj.Elidiana Shehu dhe Klodian Ali .Qëllimi i takimit është konsultim paraprak në vijim të evidentimit të Ndikimeve në Mjedis.

Bashkëlidhur prezantimi

Pyetje e Pjesëmarrësve në Degjese:

1.Ismail Dokollari – Banor

A do të ketë probleme bugetia nga ushtrimi i këtij aktiviteti?

Përgjigje-K.Ali

Ky aktivitetet gjatë fazës ndërtimore do të ndikojë në gjithsej 21 sheshe vetëm sipërfaqen rreth 0,75 ha , sipërfaqe e cila pas ndërtimit do të rehabilitohet dhe nuk impakt në mbulesën e shkurreve të uletë e cila impaktin aktivitetin e kullotjes së bagetive.

2.Kryetari i Bashkisë -Ilir Xhakolli

-Cfare përfiton komuniteti nga ky aktivitet drejtpërdrejtë.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor

Ky raport analizon ndikimet ambientale të projektit "Parku Eolik 120 MW", duke vlerësuar aspekte të tilla si biodiversiteti, peizazhi dhe ndikimi në komunitetet lokale. Ai është esencial për identifikimin e masave lehtësuese dhe përmirësimin e kërkesave ligjore.



Roli i Shoqërisë RENX ALBANIA

Shoqëria RENX ALBANIA angazhohet për promovimin e burimeve të rinovueshme si një strategji kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm. Ajo implementon praktikën më të mirë mjedisore dhe kontribuon në arritjen e objektivave kombëtare për energjinë e pastër.







Teknologjia e Turbinave të Erës

Zhvillimi i teknologjisë së turbinave të erës ka revolucionizuar procesin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Prezi

Evolucioni i Turbinave të Erës

Përdorimi i energjisë së erës ka ndryshuar ndjeshëm gjatë 20-25 viteve të fundit, me rritjen e turbinave të instaluara dhe zhvillimin e fermave të erës. Turbinat e reja ofrojnë kapacitete më të mëdha krahasuar me modelet e vjetra, duke përmirësuar efikasitetin e energjisë së rinovueshme.



Prezi




Qëllimi i Projektit

Qëllimi kryesor i projektit është shfrytëzimi i energjisë së erës për prodhimin e energjisë elektrike, duke promovuar burime të qëndrueshme dhe ekologjike për të ardhmen e Shqipërisë.

Lokacioni

Projekti do të realizohet në Njësitë Administrative Udënisht dhe Proptisht të Bashkisë Pogradec, rreth 2 km në perëndim të Liqenit të Ohrit, një zonë me potencial të lartë për energjinë e erës.





Statusi Aktual i Prodhimit të Energjisë në Shqipëri

Prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri mbështetet kryesisht në burimet hidrike, ndërsa ndryshimet klimatike kërcënojnë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji.

Prezi

Burimet Hidrike dhe Pasojat e Ndryshimeve Klimatike

Burimet hidrike përbëjnë në thelb 97% të kapacitetit të prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Megjithatë, ndryshimet klimatike, si ulla e reshjeve dhe variabiliteti i nivelit të ujit, rrezikojnë këtë sistem dhe e bëjnë prodhimin e energjisë të paqëndrueshëm.



Prezi

Matjet e Erës dhe Vendosja e Anemometrit

Për të vlerësuar përafërsisht potencialin e erës, janë kryer matje individuale në zonën e propozuar. Studimi i fizibilitetit përcaktoi vendin më të përshtatshëm për vendosjen e anemometrave, të cilët kanë ofruar të dhëna të vlefshme për zhvillimin e projektit.



Të Dhënat e Fitura dhe Zhvillimi i Projektit Teknik

Të dhënat e përftuara nga matjet e erës janë përdorur për zhvillimin e projektit teknik, duke krijuar baza të fuqishme për vendosjen e turbinave. Rezultatet tregojnë një potencial të konsiderueshëm për prodhimin e energjisë elektrike në zonë.





Studimi i Fizibilitetit

Projektet e energjisë së erës kërkojnë një analizë të thelluar të zonës dhe potencialit të erës për të garantuar suksesin e tyre.



Analiza e Zonës dhe Potenciali i Erës

Ajo pozicionohet rreth 2 km në perëndim të Liqenit të Ohrit, në një zonë me potencial të lartë për energjinë e erës. MIE ka kryer një analizë të përgjithshme për zonat e përshtatshme për zhvillimin e projekteve eolike, duke identifikuar këtë regjion si të favorshëm.



Nevoja për Burime të Rinovueshme

Të dhënat sugjerojnë se Shqipëria ka nevojë për diversifikimin e burimeve energjitike për të përballuar kërkesat e rritura dhe për të reduktuar varësinë nga energjia hidrike. Integrimi i burimeve të rinovueshme është esencial për sigurimin e stabilitetit energjetik.



Rëndësia e Energjisë së Erës

Energjia e erës po shfaqet si një alternativë e rëndësishme në përpjekjet për diversifikimin e burimeve energjitike. Ajo siguron një prodhim të pastër dhe të rinovueshëm, duke reduktuar emetimet dhe ndotjen në mjedis.



Prezantimi i Projektit

Projekti "Parku Eolik 120 MW" synon shfrytëzimin efikas të energjisë së erës në Shqipëri, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve energjetike.



Titulli i Projektit

Parku Eolik 120 MW është një iniciativë novatore e shoqërisë "RENX ALBANIA", e cila fokusohet në përdorimin e energjisë së rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike.



Karakteristikat e Turbinave SANY, Model SI-172625


Turbina SANY, model SI-172625, ka kapacitet 6.25 MW dhe është projektuar për të optimizuar prodhimin e energjisë. Ajo disponon teknologji të avancuar që rrit qëndrueshmërinë dhe efikasitetin, duke reduktuar kostot në prodhim.



WIND ENERGY
PRODUCTION

Prezi

Kapaciteti i Projektit: 120 MW dhe Prodhimi i Prerë



Projekti i Parkut Eolik me 21 turbina do të arrijë një kapacitet total prej 120 MW. Vlerësimet tregojnë se do të prodhojë rreth 380,000 MWh energji elektrike në vit, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve energjitike në Shqipëri.



-A do kete ne kontraten koncensionare nje tarife energjie qe do ti lihet popullit te Pogradecit psh per ndricim urban te rrugeve kryesore?

Pergjigje- K.Ali

Nga eksperiencia ime personale qe kemi patur edhe me projektin T.A.P shteti ka negociuar me kompanine kushtet e kontrates , silurse vete kompanite ne Politiken e tyre sociale kryejne investime publike ne zone.


Z.Kledi Lufo - Specialist i Pyjeve

Sipas specialisteve te pyjores por edhe te Bashkise Pogradec ekonomia pyjore Guri Kushtinje ku ben 90% pjese projekti ka impakt te ulet ne mjedis dhe ne pyje .

Banoret kerkuan te dine me shume per afatet e fillimit te ndertimit te ketij projekti pasi jane pro zhvillimit te ketij aktiviteti ne zonen e tyre

Pergjigje- K.Ali Ky projekt do te marre edhe afro nje vit deri ne fillimin e zbatimit te tij , kohe e nevojshme per perfundimit e projekteve te zbatimit dhe dokumentave per leje ndertimi.Sugjeroj banoreve te krijojne nje list me emra per punesim sikurse te marre masa per trainime ne fushat qe do kerkohen per punime baze .

Bashkelidhur fotot





Konsulenca Mjedisore: Environmental Management Consultants

Environmental Management Consultants janë angazhuar për të ofruar ekspertizë të pavarur për të siguruar që të gjitha standardet mjedisore të respektohen gjatë zhvillimit të projektit. Ata analizojnë të dhënat e grumbulluara dhe rekomandojnë masat për zvogëlimin e ndikimeve negative.



DATA	15.05.2018
ORIENTIM	VERIMORSHIA
SKALA	1:1000

ALBANIA SOUTH EAST WIND FARM - PROJEKTI POGRDEC
"PARKU EOLIK POGRDEC"

Simboli i Turbinës	Koordinata UTM mE	Koordinata UTM mN	KRRGJSH mE	KRRGJSH mN	Bashkia	Zona Kadastrale	Parcela
Q 01	467338.02	454499.60	551383.36	4547425.77	Pogradec	2457	154
Q 02	467268.89	4544162.76	551330.03	4546087.66	Pogradec	1317	396
Q 03	466420.70	4541043.68	550517.30	4542957.76	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 04	466852.12	4543083.96	550925.49	4545003.71	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 05	466474.81	4542286.47	550557.18	4542001.61	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 06	467391.78	4541280.17	551486.01	4543205.46	Pogradec	2973	450
Q 07	466132.45	4540304.40	550237.43	4542214.92	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 08	466034.94	4539590.50	550148.06	4541499.65	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 09	465779.32	4538905.06	549900.20	4540811.04	Pogradec	5'KA	5'KA
Q 10	465408.83	4537988.91	549541.21	4537902.29	Pogradec	3665	10
Q 11	466333.07	4537815.83	550466.62	4537217.77	Pogradec	3665	10
Q 12	466097.15	4536296.71	550248.01	4538105.41	Pogradec	3665	10
Q 13	465896.63	4535563.75	550055.81	4537609.90	Pogradec	1959	302
Q 14	466387.59	4534947.66	550553.99	4536849.22	Pogradec	1959	302
Q 15	466638.23	4534387.33	550811.14	4536301.56	Pogradec	1393	10/1
Q 16	466671.91	4538873.94	550793.46	4540790.13	Pogradec	3665	10
Q 17	467530.11	4537751.07	551664.82	4539670.70	Pogradec	3665	10
Q 18	467037.54	4536471.59	551186.73	4538391.13	Pogradec	3665	10
Q 19	467349.09	4536046.14	551303.26	4537969.09	Pogradec	3665	10
Q 20	467471.26	4537231.51	551611.90	4539156.26	Pogradec	3665	406
Q 21	466223.51	4537000.24	550366.36	4538910.64	Pogradec	1959	302






**PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 08
RENX ALBANIA SHPK**



1:1 000




Legend

○ TURBINA

□ KONTURI_TURBINA_Q_08



**PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 09
RENX ALBANIA SHPK**



4579142
4580176
4580860
4581544
4582228
4582912

458142
4582176
4582860
4583544
4584228
4584912

458500
458750
459000
459250
459500

458500
458750
459000
459250
459500

Legend


- ⊙ TURBINA
- KONTURI_TURBINA_09

PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 09
RENX ALBANIA SHPK

1:1.000



PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 10
RENX ALBANIA SHPK



TURBINA Q 10(SHESHI NDERTIMIT)				
Sistemi Gauss-Kruger		kgjsh		
Nr	X	Y	X	Y
1	4465512	4539842	549527	4539797
2	4465533	4539848	549548	4539803
3	4465538	4539827	549554	4539782
4	4465518	4539821	549533	4539776
SIPERFACIA SHESHI = 484 m2				
Q 10	4465525	4539834	549540	4539789


Legend

o TURBINA

KONTURI_TURBINA_Q_10



PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 13
RENX ALBANIA SHPK



TURBINA Q_13(SHESHI NDETIMIT)				
Sistem in Gauss-Kruger		Inglish		
Nr	X	Y	X	Y
1	4466012	4537524	590054	4537485
2	4466029	4537509	590071	4537470
3	4466014	4537093	590056	4537454
4	4465998	4537507	590040	4537467
SIPERFQDE SHESHI = 484 m2				
Q_13	4466013	4537506	590055	4537469

Legend

- TURBINA_Q_13
- KONTURI_Q_13



PLANVENDOSJA E SHESHIT
TURBINA Q 15
RENX ALBANIA SHPK



TURBINA Q 15(SHESHI NDERTIMIT)				
Sistemi i Gauss-Kruger		koordinatat		
Nr	X	Y	X	Y
1	4466770	4536314	550825	4536303
2	4466757	4536316	550813	4536285
3	4466739	4536330	550794	4536299
4	4466753	4536347	550808	4536316
SIPERFAQE SHESHI = 484 m ²				
Q 15	4466755	4536332	550810	4536301

Legend

- TURBINA_Q_15
- KONTURI_Q_15